



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202000391/4

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda :** Rekomandim për trajtimin me pension familjar të shtetases E. M. në bazë të Dekretit nr. 758, datë 01.02.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut" dhe jo në bazë të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009.

INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE  
Tiranë

Për dijjeni: Zj. E. M.  
Rr. "Mine Peza", Pall. 228., Shk. 2, Ap. 18

Tiranë

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetësja E. M., e veja e Komisar G. M., i cili është vrarë në krye të detyrës në datën 06.08.2003. Ajo pretendon se ka 8 vjet që po përballet me padrejtësi në mënyrën e trajtimit si familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në krye të detyrës. Sipas ankueses, disa familje të kësaj kategorie trajtohen me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 758, datë 01.02.1994, ndërsa disa familje të tjera trajtohen me ligjin nr. 10142, datë 15.05.2009. Familjet që trajtohen me Dekretin e Presidentit të Republikës marrin të ardhura të pacënuara të cilat rriten me VKM për pensionet, ndërsa familjet që trajtohen me ligjin nr. 10142, datë 15.05.2009, kanë një trajtim diskriminues pasi nuk përfitojnë rritje të ardhurash. Ky diskriminim bëhet nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Diferencimi në trajtim i rreth 250 familjeve ka filluar në vitin 2011. Sipas saj, për këtë shqetësim ajo i ka kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, por nuk i është dhënë asnjë sqarim për shqetësimin e ngritur. Nga kjo drejtori i është kthyer përgjigje duke i thënë se është përfituese sipas ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, ndërkohë që bashkëshorti i saj ka rënë në krye të detyrës në vitin 2003.

Gjithashtu ankuesja pretendon se, ndonëse në kushte të barabarta, shtetësja Dh.B., e veja e Y.B., ka dalë në pension dhe përfiton pension suplementar sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 758, datë 01.02.1994, ndërsa ajo nuk e përfiton këtë të drejtë.

Përveç sa më sipër, në ankesë ajo përmend edhe disa nga familjet e punonjësve të policisë të vrarë në krye të detyrës, të cilat trajtohen me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 758, datë 01.02.1994 dhe konkretisht familjet e:

1. Y.B., vrarë në vitin 2001;
2. A.Z., vrarë në vitin 2000;
3. A.S., vrarë në vitin 1997;
4. J.H., vrarë në vitin 1999;
5. A.D., vrarë në vitin 2004;
6. Xh.Sh., vrarë në vitin 2004;
7. A.D., vrarë në vitin 2009;
8. K.F., vrarë në vitin 2009;
9. S.D., vrarë në vitin 2009.

Për shqyrtimin e kësaj ankese i kemi kërkuar shpjegime Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Tiranë.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. 251/2/E prot., datë 10.04.2019, ndërmjet të tjerave na informoi se, familjarët e punonjësve të policisë që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, në çastin e lindjes së të drejtës për përfitime suplementare, janë trajtuar me akte ligjore të ndryshme si më poshtë:

1. Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 758, datë 01.02.1994, "Për mbrojtje të veçantë të ushtarakut";

2. Ligji nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë";

3. Ligji nr. 10289, datë 17.06.2010 "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës".

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë shqetësimin e familjarëve të punonjësve të policisë të rënë në krye të detyrës për trajtimin financiar të diferencuar, Policia e Shtetit ka hartuar projekt-vendimin "Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë që humbin jetën për shkak të detyrës dhe me shkresën nr. 901/1, datë 20.02.2019 projekt-vendimi i është dërguar Ministrisë së Brendshme për vazhdimin e procedurave të mëtejshme. Ministria e Brendshme me shkresën nr. E-100/3 prot., datë 11.07.2019 na informoi se, në kuadër të një sërë takimesh dhe prioriteteve të vendosura nga Ministri i Brendshëm z. Lleshaj, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit janë të angazhuara në përgatitjen e një Projekt-vendimi mbi përfitimet e familjeve të policëve të rënë në krye të detyrës. Gjithashtu na informoi se strukturat e kësaj ministrie po vijnë procedurat përkatëse ligjore për të miratuar këtë Projekt-vendim.

Ndërsa Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë me shkresën nr. 5037/1 prot., datë 11.06.2019 na informoi se, shtetësja E. M. ka përfituar pension suplementar familjar ushtaraku (rënie në krye të detyrës) me datë lindje të drejte 16.07.2011 dhe me nr. dosje 1648. Në mbështetje të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe VKM nr. 793, datë

24.09.2010, i ndryshuar, është bërë rillogaritja e pensionit mbështetur në modelarin 02 me nr. prot. 3287/1, datë 24.01.2014 të sjellë nga Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me pagë referuese në datë 01.01.2014 në shumën 71160 lekë.

Bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, masa e pensionit suplementar familjar në datën 01.01.2014 është në shumën 71160-9473=61687 lekë. Gjithashtu në këtë përgjigje u informuam se, për rillogaritjen e masës së pensionit suplementar familjar ankuesja duhet që t'i drejtohet Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit që të sjellë modelarin 02, pasi DRSSH është zbatuese e shkresave të Ministrisë së Brendshme.

Në bazë të përgjigjes së dërguar nga DRSSH, ne i kthjem përgjigje ankueses. Mirëpo ajo na është drejtuar përsëri me ankesë dhe përveç sa më sipër na shkruajti se, sipas ligjit trajtimi financiar i familjeve për shkak të humbjes së jetës së një pjesëtari të tyre, i takon gjithë anëtarëve që janë në përbërjen familjare të të rënit në krye të detyrës (janë pjesë e certifikatës familjare të tij) dhe fillon që nga data e vdekjes. Kur është vrarë bashkëshorti i saj, i ndjeri G. M., në përbërjen familjare të tij ishin vetëm ajo dhe ëma e G. M., shtetësja B. M.. Fillimisht kur filloi trajtimi i tyre financiar në vitin 2004 pensioni suplementar familjar u lidh në emër të nënës së G. M., B. M., dhe në bazë të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 758, datë 01.02.1994. Ajo u pajis nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë me librezën nr. 1648 në të cilën janë bërë edhe shënimet përkatëse, si paga referuese, shuma mujore e pensionit 53926 lekë dhe data e fillimit të tij, më 07.08.2003.

Në vitin 2005 ajo i është drejtuar me një kërkesë Institutit të Sigurimeve Shoqërore pasi kishte paqartësi në lidhje me të ardhurat. Me shkresën nr. 1752/2, datë 02.09.2005, Instituti i Sigurimeve Shoqërore sqaron se, familja e G. M. trajtohet sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 758, datë 01.02.1994 dhe ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, neni 40. Meqënëse pretendimi i saj ishte që të trajtohej sipas Gradës Policore që kishte G. M. në kohën e vrasjes, i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Gjykata me vendimin nr. 6926, datë 24.11.2005 pranoi kërkesën e saj duke bërë ndryshimin e pagës referuese dhe për rrjedhojë edhe të masës së pensionit mujor nga 53926 lekë në 71000 lekë.

Pasi vendimi gjyqësor mori formë të prerë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dërgoi dokumentacionin në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë. Kjo drejtori bëri zbatimin e vendimit gjyqësor duke përlllogaritur edhe diferencat nga data 07.08.2003, të cilat janë tërhequr nga ana e saj. Deri në vitin 2011, kur B. M. (e ëma e G. M.) ndërroi jetë, pagesat e pensionit familjar i kanë marrë të plota duke përfituar edhe rritjen sipas VKM nga viti në vit dhe pensioni arriti në shumën 98808 lekë.

Në muajin Korrik 2011 ankuesja ka bërë kërkesë për kalimin e pensionit suplementar familjar nga emri i vjehrrës në emër të saj, pasi pensioni është një e drejtë që vazhdon për familjarët e gjallë. Pas një muaji ajo është interesuar sepse nuk po përfitonte pagesën që kishte marrë deri në atë kohë. Nga specialistët e sektorit të pensioneve suplementare të DRSSH Tiranë i është thënë se ajo nuk do të trajtohej sipas Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 758, datë 01.02.1994, por sipas ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009. Vendimin e marrë nga kjo drejtori ajo e ka kundërshtuar sipas hirarkisë, por nuk ka mundur që ta zgjidhë. Nga DRSSH Tiranë i është thënë se asaj i lind e drejta e pensionit suplementar nga data 18.07.2011, ndërkohë që ajo dhe vjehrra e saj e kanë përfituar këtë të drejtë që në vitin 2003 dhe një e drejtë e fituar nuk mund të çenohet më vonë. Sipas saj, kërkesa që ka bërë në vitin 2011 ka qënë jo për të përfitimin e pensionit suplementar, por për kalimin e tij nga një emër në tjetrin, sepse vjehrra e saj ndërroi jetë. Mirëpo kjo kërkesë është keqpërdorur nga punonjësit e DRSSH Tiranë duke i ulur masën

e pensionit për shkak të ndryshimit të bazës ligjore, nga trajtimi me dekret, në trajtim me ligj. Sipas saj, ky ndryshim i bazës ligjore dhe për rrjedhojë edhe i masës së përfimit të pensionit suplementar familjar nga punonjësit e DRSSH Tiranë është i kundërligjshëm sepse kur asaj i ka lindur kjo e drejtë ligjore ishte në fuqi Dekreti Presidentit të Republikës nr. 758, datë 01.02.1994.

Ndërkohë ankuesja pretendon se kërkesa e bërë në emër të saj në DRSSH Tiranë e regjistruar me nr. 178 prot., datë 20.10.2011 është e falsifikuar dhe ky fakt është provuar edhe nga ekspertiza kriminalistike, ekzaminimi grafik nr. 11.02, datë 18.02.2019 që i është bërë këtij dokumenti nga eksperti kriminalist Valter Haxhiraj, fotokopjen e të cilit na e ka dërguar së bashku me ankesën. Sipas këtij akti rezulton se, nënshkrimi i plotë emër mbiemër - firmë, shkruar në emër të shtetases E. M. në dokumentin objekt ekspertimi me nr. 178 prot., datë 20.10.2011, nuk është shkruar nga shtetësja E. M.. Sipas ankueses, kopjen e aktit të ekzaminimit grafik nr. 11.02, datë 18.02.2019 e ka dorëzuar në DRSSH Tiranë.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, me shkresën nr. K2/E24-10 prot., datë 24.09.2019 i kërkuam DRSSH Tiranë verifikimin e saj dhe dërgimin e një informacioni shtesë lidhur me pretendimet e ankueses dhe konkretisht se cilat kanë qënë shkaqet dhe arsyet ligjore që për shtetasen E. M. është ndryshuar baza ligjore e përfitimit të pensionit suplementar familjar dhe për rrjedhojë ulja e masës së tij.

Nga DRSSH Tiranë me shkresën nr. 9569/1 prot., datë 03.10.2019, përveç informacionit të dërguar edhe me shkresën e parë na informoi se, sipas kërkesës së Znj. E. M. nr. 179 prot, datë 20.10.2011 pranë DRSSH Tiranë i është caktuar pension "Rënie në krye të detyrës" sipas ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009. Gjithashtu kjo drejtori na informoi se në nenin 31 të këtij ligji citohet se: *"Shfuqizohet Dekreti nr. 758, datë 01.02.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut"*.

Për këto arsye bazuar në nenin 21 të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, pensioni suplementar familjar është sa diferenca ndërmjet pagës referuese të të ndjerit/së ndjerës, në çastin e humbjes së jetës dhe pensionit familjar, që përfitonte sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Pra masa e pensionit suplementar familjar më 01.01.2014 është 71160 - 9473 = 61687 lekë.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe të përgjigjeve të cituara më sipër konstatojmë se:

1. Familjes së të ndjerit G. M. i është dhënë pension familjar për arsye të humbjes së jetës, vrasjes, në krye dhe për shkak të detyrës në bazë të nenit 3<sup>1</sup> të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 758, datë 01.02.1994, i cili ishte në fuqi në kohën e vrasjes së tij. Ky fakt provohet nga dokumentacioni i administruar nga ana jonë dhe konkretisht librezës së pensionit të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë me nr. 1648 në emër të nënës së tij, të ndjerës B. M. dhe me datë lindjeje, fillimi të tij, më 07.08.2003.

2. Nga përmbajtja e nenit 3 të këtij Dekreti rezulton se pavarësisht faktit që pensioni familjar jepet në emër të njërit prej përfituesve, atë e përfitojnë dhe gëzojnë të gjithë pjesëtarët e familjes së të ndjerit që ka humbur jetën. Në rastin konkret pensioni për

---

<sup>1</sup> Kur ushtaraku për shkak të detyrës e si rrjedhojë e veprimeve të dhunshme ndaj tij, humbet jetën, pjesëtarët e familjes përfitojnë pension familjar në masën 100 për qind të pagës mujore të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, pavarësisht nga periudha e sigurimit të të ndjerit. Pjesëtarët e familjes dhe kushtet në të cilat ata e përfitojnë këtë pension, janë ata të përcaktuar në nenin 40, pika 2 dhe 3, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993. Pjesëtarët e familjes që gëzojnë një pension tjetër, kanë të drejtë të zgjedhin njërin, më të favorshmin. Pensioni familjar jepet në emër të njërit nga përfituesit, sipas radhës së përcaktuar në nenin 40, pika 2, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993. Në rastet kur për shkaqe të ndryshme, lind nevoja e ndarjes së pensionit familjar ndërmjet përfituesve, masa konkrete për secilën caktohet me vendim të Gjykatës. Në këto raste fëmijët përfitojnë jo më pak se 50 për qind të shumës së pensionit familjar.

të ndjerin G. M. i është dhënë nënës së tij, të ndjerës B. M., por atë e ka përfituar edhe bashkëshortja e tij, shtetësja E. M.. Gjatë kohës që ishte gjallë nëna e tij B. M. nuk ka lindur nevoja e ndarjes së masës së pensionit ndërmjet saj dhe bashkëshortes së të ndjerit E. M..

3. Shfuqizimi i Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 758, datë 01.02.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut" nga neni 31 ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, nuk do të thotë që të shfuqizohen të gjitha vendimet administrative të marra nga organet kompetente, sikurse janë edhe strukturat e Sigurimeve Shoqërore në vend, si dhe të shfuqizohen apo revokohen të drejtat e përfituara mbi bazën e tij nga pjesëtarët e familjeve të ushtarakëve që kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës. Në fakt, me përjashtim të këtij rasti, kështu është vepruar edhe nga DRSSH Tiranë, sepse janë disa familje të punonjësve të Policisë së Shtetit të vrarë në krye apo për shkak të detyrës, të referuara nga ankuesja të cilat i kemi cituar më sipër që vazhdojnë të trajtohen sipas Dekretit nr. 758, datë 01.02.1994. Shfuqizimi i këtij Dekreti do të thotë që, trajtimi i familjarëve të ushtarakëve, përfshirë edhe punonjësit e Policisë së Shtetit, që humbin jetën për shkak apo në krye të detyrës pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk do të bëhet sipas Dekretit, por sipas ligjit nr. 10124 datë 15.05.2009. Përveç sa më sipër theksojmë faktin e rëndësishëm se, ligji nr. 10124 datë 15.05.2009 nuk ka fuqi prapavepruese dhe për rrjedhojë nuk mund të revokojë të drejtat e përfituara nga Dekreti. Ndërkohë ju sjellim në vëmendje se rasti në fjalë, humbja e jetës së të ndjerit bashkëshortit të ankueses ka ndodhur në vitin 2003 dhe pensioni familjar për këtë rast është përfituar tashmë në kohën e ndodhjes së ngjarjes dhe sipas ligjit të kohës kur ishte në fuqi Dekreti nr. 758, datë 01.02.1994. Pra, ky rast nuk mund dhe nuk duhet të trajtohet si një rast i ri i përfitimit të pensionit familjar, sepse pensioni është përfituar. Në këtë rast ndodhemi para nevojës së ndryshimit të emrit të përfituesit të pensionit familjar, nga B. M. në E. M. për shkak të vdekjes së B., si njëra prej të dy përfituesve në emër të së cilës ishte lidhur pensioni dhe lëshuar librezja.

4. Kërkesa e bërë në emër të shtetases E. M. regjistruar në DRSSH Tiranë me nr. 179 prot, datë 20.10.2011, mbi bazën e të cilës ankueses i është caktuar pension "Rënie në krye të detyrës" sipas ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, sikurse është parashtruar edhe më sipër, ka rezultuar se është e falsifikuar. Ky fakt është provuar nga ekspertiza kriminalistike, ekzaminimi grafik nr. 11.02, datë 18.02.2019 që i është bërë këtij dokumenti nga ekspertimi kriminalist Valter Haxhiraj, kopja e të cilës i është dhënë kësaj drejtorie nga ankuesja.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj ankese vlerësuam se, shtetases E. M. i është cenuar një e drejtë e ligjshme e garantuar nga neni 3 i Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 758, datë 01.02.1994, sepse i është ulur masa e përfitimit të pensionit familjar mujor. Ndërkohë konstatojmë se, nga ana DRSSH Tiranë në trajtimin e këtij rasti është cenuar edhe parimi i sigurisë juridike dhe i barazisë para ligjit të garantuara nga nenet 4/1<sup>2</sup> dhe 18/1<sup>3</sup> i Kushtetutës, sepse disa familje të punonjësve të Policisë së Shtetit me të drejtë vazhdon t'i trajtojë me Dekretin nr. 758, datë 01.02.1994, ndërsa ankuesen e ka trajtuar me ligjin nr. 10142, datë 15.05.2009, ndonëse e drejta i ka lindur në kohën kur ishte në fuqi Dekreti në fjalë.

Për sa më sipër dhe me qëllim rivendosjen në vend të të drejtës ligjore të shkelur shtetases E. M., bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*" dhe në gërmën "b" të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: "*Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur*

---

<sup>2</sup> E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

<sup>3</sup> Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, me shkresën nr. K2/E24-12 prot., datë 11.12.2019 drejtuar DRSSH Tiranë rekomandim:

“1. Marrjen e masave të nevojshme për trajtimin me pension familjar të shtetases E. M. në bazë të Dekretit nr. 758, datë 01.02.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut".

2. Marrjen e masave të nevojshme për dhënien shtetases E. M. të diferencës të shumave monetare të mbajtura në mënyrë të padrejtë për shkak të ndryshimit të bazës ligjore të trajtimit të saj me pension familjar që nga data 16.07.2011.”

DRSSH Tiranë me shkresën nr. 1696/1 prot., datë 03.03.2020 ndërmjet të tjera na informoi se nuk e ka pranuar rekomandimin tonë.

Meqënëse DRSSH Tiranë nuk e ka pranuar rekomandimin tonë, për të bërë të mundur rivendosjen në vend të të drejtave të shkeluara ankueses, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në nenin 21/c të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen;”,

### **REKOMANDOJMË**

*Marrjen e masave të nevojshme, në cilësinë e organit epror të Drejtorisë Rajonale të Sigurimëve Shoqërore Tiranë për trajtimin me pension familjar të shtetases E. M. në bazë të Dekretit nr. 758, datë 01.02.1994 "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut".*

*2. Marrjen e masave të nevojshme për dhënien shtetases E. M. të diferencës të shumave monetare të mbajtura në mënyrë të padrejtë për shkak të ndryshimit të bazës ligjore të trajtimit të saj me pension familjar që nga data 16.07.2011.”*

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda Ballanca**

Konceptoi: S. Nushi

Miratoi: E. Ruspi